Po kështu u veprua edhe në vendbanimet e Suharekës⁶, Prizrenit⁷, Gjakovës etj. Në katundin Babaj i Bokës të Gjakovës,

⁶AQSH.F.410.V.1944.D.58.FI. 16, Lista e të vrarëve nga ushtria serbe gjatë vitit 1912 në fshatrat e komunës së Banjës: Liman Sahiti, Hajrullah Rexhepi, Hasan Isufi, Asllan Islami, Bislim Shabani, Beqir Shabani, Hasan Hajdari, Haxhi Behrani, Ali Mehmeti, Sadik Alija, Hysejn Hamza, Musli Hamza, Jashar Hasani, Xhylije Jashari, Shaqir Ibrahimimi, Beqir Ibrahimimi, Hajredin Demiri, Hamza Haliti, Sejdi Rrustemi, Islam Rrustemi, Zizë..., Fejzullah Beqiri, Zenel Muslija, të gjithë nga fshati Banjë; Beqir Rexhepi, Adem Sahiti, Ymer Alija, nga fshati Senik; Beqir Abdullahu, Qelebi Abdullahu, Shaqir Abdullahu, Islam Shasivari, Halit Mustafa, Asllan Sahiti, Riza Mehmeti, Selman Baftjari, Sali Fejza, Sadri Zeqa, Halit Rexha, Osman Murseli, Selman Sula, Zulfa Mustafa, Shaban Alija, Ibrahim Velija, Feta Ademi, Hysejnë Shama, Riza Veseli, Hasan Azemi, Asllan Shasivari, Demë Zenuni, Shaqir Aredullau, Bahta Aredullau, Halil Mustafa, Xhemail Hajrullahu, Emin Xhema, Asllan Sahiti, Hysejnë Destani, Sejdi Feka, Xhemail Ibrahimimi, Hamdi Iljazi, Latif Bajrami. Janë të plagosun dhe këtë: Beqir Salihi, Ymer Hasani, Hoxha Lladrofc, Xheladin Jetullahu, Behlul Bala, Sali i Xhemës, nga fshati Bellanicë;

Ibrahim Sinani? Shaban Sinani, Shaqir Sadrija, Jetullah Saliu, Nuredin Shabani, Xheladin Emimi, Feriz Meta, Rexhep Sela, Abaz Ahmeti, Mersel Zema, Musli Jakupi, nga fshati Lladroviq; Sali Uka, Lah Hoxha, Qekin Syl, nga fshati Gucat.

⁷AQSH.F.410.V.1944.D.112.FI.2, Lista e të vrarëve gjatë vitit 1912 nga ushtria serbe në rajonin e Komunës së Zhurit: 1) Shaban Halili, 2) Ramadan Shabani, 3) Fetah Beqiri, 4) Kasem Beqiri, 5) Xhelil Dauti, 6) Bajram Tahiri, 7) Ramadan Shaqiri, 8) Nuredin Shabani, 9) Xhelil Dauti, 10) Sadri Ismahili, 11) Sulejman Asllani, 12) Fazli Murati, 13) Qazim Elezi, 14) Latif Murseli, 15) Mehmet Kamberi, 16) Bajram Avdija, 17) Sinan Murati, 18) Selman Syl, 19) Ali Zenuni (të gjithë nga katundi Zhur); 20) Hysen Tahiri, 21) Maliq Tahiri, 22) Halim Tahiri, 23) Halil Tafa, 24) Nuredin Arifi, 25) Adem Fetahi, 26) Dalip Bislimi, 27) Xhemë Bislimi, 28) Ramë Maksuti, 29) Zulfi Maksuti, 30) Asllan Zeqiri, 31) Shazivar Shaqiri, 32) Zeqir Ibishi, 33) Mahmut Ibishi, 34) Bajram Ibishi, 35) Smalj Bajrami, 36) Ukë Murati, 37) Halil Murati, 38) Hajdar Ibishi, 39) Hodë Dauti, 40) Iljaz Mahmuti, 41) Imer Rushiti, 42) Xhafer Rushiti, 43) Sahid Dervishi, 44) Brahim Dervishi, 45) Selman Ibrahimimi, 46) Myrte Dervishi, 47) Mustafë Dervishi, 48) Delul Myrta, nga katundi Dobrusht; 49) Sinan Rrustemi, 50) Veli Sinani, 51) Isuf Alija, 52) Hasan Ademi, 53) Myrteza Hasani, 54) Belul Zeneli, 55) Avdullah Sulejmani, 56) Ragip Sulejmani, 57) Baftjar Mehmeti, 58) Sahit Asllani, 59) Imer Sinani, 60) Bilall Imeri, 61) Tafë Limani, 62) Sadik Durmishi, 63) Dalip Imeri, 64) Bajram Shabani, 65) Muharem Jemini, 66) Tafil Jashari nga katundi Vërmicë; 67) Bajram Pajaziti, 68) Zenel Bajrami, 69) Mustafë Kurtishi, 70) Ramë Alija, 71) Dan Alija, 72) Zyber Alija, 73) Ramadan Jonuzi, 74) Ajvaz Rama, 75) Xhafer Jonuzi, 76) Sefi Jashari, 77) Halil Sefa, 78) Islam Jashari, 79) Shani Miftari, 80) Avdul Miftari, 81) Tahir Hamiti, 82) Selman Osmani, 83) Muharem Alija, 84) Demir Myrtezaji, 85) Mustafë Myrtazaji, 86) Raman Ahmeti, 87) Osman Fetahi, 88) Ahmet Fetahi, 89) Selman Kurtishi, 90) Isuf Xhelili, 91) Dulë Isufi, 92) Mazllum Kurtishi, 93) Dervish Ahmeti, 94) Nuredin Ahmeti, 95) Sinan Serjani, 96) Qibrit Salihi, 97) Mehmet Tamili, 98) Sinan Tamili,

ushtria serbe gjatë vitit 1912 dogji 64 shtëpi dhe fshatarëve ua konfiskoi tërë pasurinë përfshi edhe bagëtinë dhe vrau 9 burra, 2 gra⁸, ndërsa 10 fëmijë i dogji në zjarr për së gjalli.⁹ Ky krim i shëmtuar erdhi pasi paraprakisht disa banorë të këtij fshati në krye me Jan Salihun, kishin vra 5-6 ushtarë të një patrulle të ushtrisë serbe, e cila kishte tentuar të futej në fshat me qëllim të plaçkitjes të pasurisë së tyre.¹⁰

Mizorive dhe barbarizmave serbe dhe atyre bullgare nuk i shpëtoi as popullsia shqiptare e Kërçovës. Në pranverën e vitit 1913 disa grupe komitësh dhe çetnikësh serbë e bullgarë të udhëhequr nga Mihalj Brodi dhe Stanku Dimitru, pasi e rrethuan qytetin morën të gjithë burrat shqiptarë dhe i dërguan në tre vende të caktuara si thertore (dajakhane): “Çiflik” që gjendej në afërsi të shkollës bullgare “Biçincë-Jurije”, si dhe në shkollën fillore në qendër të qytetit. Shumë nga ata janë vlarë me pushkë, një pjesë tjetër janë therur me thikë, ndërsa ka edhe nga ata që kanë vdekur nga të rrahurit me dru. Kryetari i Bashkisë së Kërçovës, në raportin e datës 20 korrik 1942 dërguar nënprefekturës së Kërçovës, veç tjerash shkruante se, tërë kjo situatë kishte zgjatur rreth dy muaj, gjatë së cilës: “... *Shqiptarët ma të mirë janë therun, disa me pushkë janë vramun e ma shumë me dru janë rahun prej të cillavet shumica mbas disa kohrash kanë vdekur.....çetnikët-komitët i ngarkojshin me araba dhe i gropojshin rreth qytetit me disa gropa qi ishin përgatitun apostafat për këtë qëllim dhe këta gropa ende sot janë ku pushojnë kockat e këtyre Shqiptarve...Kjo ka qenë një jav e zez për të mjerët Shqiptarë sepse thereshin si kundra kasapët kur therin qingjet në thertore”.¹¹*

99) Kasem Tamili, 100) Ramadan Idrizi, 101) Zyra Shatifi (të gjithë nga katundi Billushë); 102) Halil Salih me nanë, 103) Emërilla Zenuni, 104) Xhimshit Selimi, 105) Halit Ramadani nga katundi Hoçë.

⁸AQSH.F.410.V.1944.D.112. Fl. 2, Lista e të vlarëve gjatë vitit 1912 në katundin Babaj i Bokës së rrethit të Gjakovës: Bajram Musa, Hysen Bajrami, Adem Tahiri, Zenun Sadiku, Ukë Salihu, Emin Dobroshi, Isuf Murseli, Brahim Sadiku, Kadri Zenuni, Nifa e Hasan Zymerit dhe Gjylsimja e Haxhi Mustafës.

⁹Po aty, Lista e fëmijëve të djegur në zjarr nga ushtria serbe: Metush Hasani, Sofe Brahimi, Sejd Cana, Kadë Ahmetaj, Zelfi Metaj, Mehmet Sylja, Zeqir Sadria, Fatime Bajrami, Sylë Ahmeti dhe Zyher Salihu.

¹⁰Po aty.

¹¹ДАРМ.Ф.Општина Кичево 1941-1944, кут. 2., Raport i kryetarit të Bashkisë së Kërçovës, dërguar nënprefekturës së Kërçovës, mbi krimet dhe masakrat serbe e bullgare ndaj popullsisë shqiptare të Kërçovës me rrethinë, midis periudhës 1912-

Masakra të tilla e të ngjashme gjatë viteve 1912-1913 u kryen thuajse në tërë hapësirën e pushtuar shqiptare dhe për pasojë mbi 150 000 shqiptarë u detyruan t'i lëshonin vatrat e tyre për t'u vendosur kryesisht në Turqi, pjesa më e madhe e të cilëve jetonin në kushte të mjerueshme, të zhveshur e të zbathur dhe pa kulm mbi kokë.¹² Gazeta “Përlindja e Shqipëniës”, shkruante se gjendja e shqiptarëve që ishin vendosur në Stamboll ishte *“si ska ma keq! Robot copë-copë; të pangrënë..., shumë nga ata i kanë mbyllur në xhamijën që quhet e Sirqexhis. Gjindarët dhe policët u- rinë reth e përçark me sfyngji në pushkë, se mos ikin”*.¹³

Ndërkohë, pas ultimatumit të marrë nga Fuqitë e Mëdha (gusht 1913), që trupat serbe të tërhiqeshin brenda kufijve të përcaktuar në Konferencën e Londrës, qeveria serbe, si kundërpërgjigje, shtetasve shqiptarë ua ndaloi shfrytëzimin e tregjeve në Dibër, Prizren dhe Gjakovë. Një vendim i tillë e revoltoi tej mase popullsinë lokale, e cila revoltë së shpejti kaloi në një kryengritje të përgjithshme.¹⁴ Zyrtarët politikë e ushtarakë serbë nga Shkupi, Manastiri, Ohri, Prizreni, raportonin për një lëvizje të madhe që dukej në horizont. Shtytje të madhe lëvizjes i jepnin shqiptarët në krye me Elez Isufin, Bajram

1941, Kërçovë, 20 korrik 1942, shih, listën e shqiptarëve civilë të vvarë nga çetnikët serbë në qytetin e Kërçovës gjatë viteve 1912-1913: Hasan Dalip Beu, i therur me thikë në vitin 1912; Bahri Bejtullahu, i vra me pushkë dhe i therur me thikë në vitin 1912; Halit Emërllahu, i therur me thikë në vitin 1912; Hajredin Male Sulko, i therur brenda në xhami të qytetit në vitin 1912; Muharrem Himeti, i therur brenda në xhami të qytetit në vitin 1912; Ismail Kamberi, i therur brenda në xhami të qytetit në vitin 1912; Mehdi Shejdo, i mbytur me dru në vitin 1913; Alo Shejdo, i mbytur me dru në vitin 1913; Rushit Kofçe, i mbytur me dru në vitin 1913; Behlul Hasani, i therur me thikë në vitin 1913; Rexhep Dervishi, i therur me thikë në vitin 1913; Hazir Reshiti, i mbytur me dru në vitin 1913 dhe Zylfiqar Zeneli, i vvarë me pushkë në vitin 1913.

¹²Arhiv Jugosllavije, Fond Kralevski Generalni konsulat u Carigradu, fascikl br. 22, Jedinica opisa br. 334-335 (më tej: AJ.370.22/334-335), Raport i konsullit jugosllav në Stamboll, dërguar ministrit të Jashtëm në Beograd, Vojislav Marinković, mbi Marrëveshjen Shqiptaro-Turke për riatdhësimin e kolonisë shqiptare nga Turqia për në Shqipëri, Stamboll 27 maj 1927.

¹³“Përlindja e Shqipëniës”, e Shtunë 7/20 Dhetuer, 1913, 5.

¹⁴Државен Архив на Република Македонија (мë tej ДАРМ), 1.18.5.214/414-424, Post Office telegraphs, SSS Belgrade Min 603 -1028-28/9-3, Legation Serbe London.

Currin, Isë Boletinin etj.¹⁵

Ky i fundit, në një deklaratë dhënë korrespondentit të “Albanesische Korrespondenz”, ua bëri me dije Fuqive të Mëdha, se shqiptarët nuk marrin asnjë barrë përsipër, për “luftërat” që mund të shpërthejnë së shpejti. “*Neve, shprehet Boletini, ju tham qeverritarvët të Romës, të Vjenës, të Parizit dhe të Londrës që populli ynë kurrë nuk mund të duronjë të copëtohet. Pas trembëdhjetë kryengritjeve të përgjithshme, në të cilat derdhëm kaq gjak për liriën t’onë, na dha më në funt Evropa ç’varjen t’onë (pavarsinë tonë – Q. L.). Por gjysëm më të madhe të kombit, duanë t’i a bëjnë theror armiqvet. Kosova, zëmra e Shqipëriës, po na humbet. Fiset e Hotit e të Grudës, të cilat luftuanë kaq trimërisht për çështjen shqiptare, po i japin Malit t’ Zi. 34 qytete shqipëtare u dhanë në duartë e anmiqve tanë. Me gjith këtë, Sërbët po i vdesin unit Malësorët. Ju mbajtën udhët për në Gjakovë, Prizren dhe në të gjitha pazaret e tjera, me të cilat rnojnë, dhe në qoftë se ndonjë merr rugën për në qytet, menjëherë vriten. Na Shqiptarët duamë paqe; po duhet të mprojmë vehten në qoftë se popullin t’onë e coptojnë, e vdesin unit dhe e vrasin*”.¹⁶

Kryengritja filloi natën e 18/19 shtatorit 1913 në rrethin e Peshkopisë.¹⁷ Kryeshefi i qarkut të Dibrës, përmes telegrameve të 7 (20) dhe 8 (21) shtatorit, njoftonte se “rreth Peshkopisë po zhvillohen luftime me shqiptarët”. Më 9 (22) shtator, Ministria e Punëve të Brendshme të Mbretërisë Serbe, njoftonte se “shqiptarët janë 10 kilometra në afërsi të Dibrës”, ndërsa “Peshkopia dhe Zhirovica janë marrë”.¹⁸ Konti Berchtold, më 24 shtator 1913, përmes një qarkoreje i njoftonte përfaqësitë diplomatike austro-hungareze, se kryengritja shqiptare ishte provokuar nga “brutaliteti serb”, ndërsa pjesëmarrja e shqiptarëve ishte vetëm në zonat e pushtuara nga ana e serbëve që ishte në kundërshtim me vendimet e Londrës, ose nga popullsia e zonave që “u është ndërprerë furnizimi me ushqime për shkak të

¹⁵ Xheladin Shala, Veprimtaria kombëtare e Isa Boletinit në vitet 1912-1916. Në *Gjurmime albanologjike - Seria e shkencave historike* 26-1996, Instituti Albanologjik, Prishtinë 1997, 139-140.

¹⁶ “Perlindja e Shqipëniës”, 21 gusht/3 shtator 1913, 3-4.

¹⁷ Purellku, Halim, *Zona e pushtimit jugosllav në Shqipëri (1918-1921)*. Instituti i Historisë, Tiranë 2012, 17-19.

¹⁸ Po aty.

pengesave për të shkuar në tregun e Dibrës e të Gjakovës”.¹⁹

Një qëndrim të tillë pati edhe Komisioni Hetimor i Fondacionit Carnegi, i cili në raportin kushtuar kësaj ngjarjeje shkruante, se më 20 shtator 1913, ushtria serbe duke u tërhequr përmes kufirit në afërsi të Dibrës, mori të gjithë bagëtinë nga Malësia e Dibrës, për çka “barinjtë u shtrënguan të mbroheshin”. Më tej në raport theksohej se, ushtria serbe pasi i vrau të gjithë barinjtë, filloi të grabiste dhe digjte “të gjithë fshatrat në rrugën e tyre: Peshkopinë, Pletzën dhe Dohoshishtin në Dibrën e Poshtme dhe Allajbegun, Maçin, Parën, Obokun, Klloboçishtin dhe Sollokiçin, në Dibrën e Sipërme”, dhe se në të gjitha këto fshatra, serbët “kryenin veprime të tmerrshme masakrimi dhe dhune mbi gratë, fëmijët dhe pleqtë... etj.”²⁰

Më 20/21 shtator, rreth 6 000 kryengritës e kapërcyen Drinin e Zi dhe u futën në qarkun e Dibrës. Kryengritësit fillimisht çliruan Peshkopinë dhe më pas edhe Dibrën dhe Zhirovnicën.²¹ Më 26 shtator 1913, Aqif Pashë Elbasani i telegrafonte Qeverisë së Përkohshme të Vlorës, se forcat shqiptare ishin ndarë në tre krahë: krahu kah Gostivari kishte çliruar Mavrovën dhe shpresohej se deri në mbrëmje ta çlironte edhe Gostivarin; krahu që marshonte për Kërçovë kishte kaluar Loposhin, dhe krahu i tretë, i ishte afruar Strugës. “... *Me ndihmën e Perëndisë, shkruante Aqif Pasha, sukseset po vazhdojnë. Të tre krahët e përmendur, lajmërohem i se përbëhen prej 12 000 vetash, dhe po luten e thërrasin çdo minutë për armë dhe municion...*”²² “Perlindja e Shqipëniës”, më 21 shtator (4 tetor) 1913, përcillte njoftimin e korrespondentit të “Algemeine Zeitung” nga Shkodra, ku thuhej se çetat shqiptare të udhëhequra nga Isë Boletini dhe Bajram Curri e mposhtën ushtrinë serbe në Dibër dhe në afërsi të Prizrenit dhe se në Beograd ishte përhapur lajmi se “shqiptarët hynë në Tuz duke

¹⁹ ДАРМ, F. Arkivi i Vjenës: HHSTA WIEN Polit. Archiv I Fasz. 1114 Ende, Vm=14 M F S., Graf Berchtold an die k.u.k. Missionen in Berlin, Haag, Paris, Rom un St. Petersburg, Telegramm, Wien, 24 Septeber 1913.

²⁰ Joseph Swire, *Shqipëria - Ngritja e një mbretërie*, Dituria, Tiranë 2005, 151.

²¹ ДАРМ.1.766.27.92/419-422, “Радничке новине” бр. 189, од 12 септембра 1913, XIII, ТРЕЌИ РАТ НА БАЛКАНУ.

²² AQSH.F.145.V.1913. D. II-52.Fl.32, Telegram i prefektit të Elbasanit, Aqif Pashës, drejtuar Kryesisë së Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës, me të cilin njofton mbi sukseset e kryengritësve shqiptarë në Dibër dhe propozon masat për t’i ndihmuar me armë e municion.

dëbuar ushtarët malazezë që gjendeshin atje”.²³ Më 24 shtator inspektori i policisë serbe nga Shkupi, njoftonte se shqiptarët ishin nisur në dy drejtime: një kolonë nga Elbasani për në Ohër, ndërsa e dyta nga Dibra për në Strugë dhe se shqiptarët e kishin marrë Mavrovën.²⁴ Ndërsa, më 26 shtator, autoritetet policore serbe nga Ohri njoftonin se shqiptarët nga Qafë-Thanë ishin nisur për në Strugë dhe Ohër, ndërsa grupi i dytë nga Elbasani për në Pogradec”.²⁵ Edhe kryeshefi i qarkut të Prizrenit bënte me dije se shqiptarët nga Shqipëria kishin filluar të kalonin nga ana e majtë e Drinit të Zi në krahinën e Lumës dhe të grumbullohen në masa më të mëdha te fshati Ratkajë. Plani i tyre ishte të koncentroheshin për ta sulmuar Prizrenin”.²⁶

Menjëherë pas sulmit të befasishëm në Dibër dhe më pas edhe në: Strugë, Ohër, Prizren, Gjakovë dhe në qendra e vende të tjera, qeveria serbe vendosi të mobilizojë Divizionin e Moravës, përkatësisht, njësitet e saj I, II, III dhe XIV të këmbëorisë. Më 29-30 shtator 1913, filloi kundërofensiva e ushtrisë dhe e çetave çetnike serbe. Në luftimet disaditore, ushtria serbe e pajisur me armatim bashkëkohor të kohës, arriti t’i thyejë forcat kryengritëse fillimisht në frontin e Strugës, Ohrit e Dibrës e më pas edhe të Prizrenit e Gjakovës.²⁷

Forcat ushtarake serbe pasi ripushtuan tokat shqiptare, kryen gjenocid të paparë ndonjëherë mbi popullsinë civile shqiptare. *Radničke novine*, më 22 tetor 1913, botoi letrën e një ushtari serb, në të cilën veç tjerash thuhej: *“Nuk kam kohë t’ju shkruaj gjatë, por mund t’ju them që këtu po ndodhin gjëra ngjethëse. Unë jam i tmerruar prej tyre dhe vazhdimisht pyes veten time se si njerëzit mund të jenë kaq barbarë, sa të kryejnë mizori të tilla. Është e tmerrshme, unë nuk guxoj t’ju them më shumë, por mund t’ju them se Luma nuk ekziston më. Ka fshatra me njëqind, njëqind e pesëdhjetë, dyqind shtëpi ku nuk ka ma asnjë burrë, në kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalës, asnjë. Ne i grumbulluam ata në grupe nga dyzet deri në pesëdhjetë veta dhe pastaj i shpuam me bajoneta tona...”*.²⁸ Lidhur me krimet

²³ “Perlindja e Shqipëniës”, 21 shtator (4 tetor) 1913, 5.

²⁴ ASHAK, A. Diplomati i Sekretariatit Fedarativ të Punëve të Jashtme - Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915, РЕФЕРАТ о упаду Арнаута, 95/1-4.

²⁵ ДАРМ.1.18.5.214/414-424.

²⁶ По ату.

²⁷ *Radničke Новине*, 22 септебра 1913 год., Београд.

²⁸ Swire, Joseph..., 152.

dhe masakrat që ushtria serbe i kreu në Lumë, Dimitrije Tucoviq, shkruante se një fshat i kësaj krahine brenda dy orësh “është zhdukur” tërësisht me skena “që është vështirë të përshkruhen. Të shtënat, - vazhdon Tucoviq, - i rrëzonin gratë që mbanin foshnjën në gjinj; skaj nënave të vdekura qanin fëmijët e tyre të vegjël që rastësisht kishin shpëtuar nga plumbat; trupat e malësoreve të bukura, belholla si bredhat, përdridheshin si krimbat në fushë; gratë lindnin nga frika. Për dy orë u vranë 500 shpirta...”.²⁹

Vrasje masive të popullsisë civile, djegie të vendbanimeve të tëra ishin të shumta. Sali Hoxhë Vuçitërna i shkruante Luigj Gurakuqit, për përfundimin e luftës së përgjithshme, se Hysni Curri është kthyer, dhe se “... Krasniqja, Gashi, Hasi, Bytyçi janë djegë fare. Robni e madhe ash tuj ardhë këtu.”³⁰ Për të shpëtuar nga këto mizori dhe barbarizma serbe, numri i madh i popullsisë shqiptare, të: Dibrës, Gostivarit, Kërçovës, Strugës dhe Ohrit, i braktisën vatrat e tyre për t’u vendosur brenda kufirit shqiptar, kryesisht në Tiranë dhe Elbasan. Shkrimtari dhe kulturologu shqiptar nga Dibra, Haki Stërmilli, në veprën e tij “Dibra në prag të historisë” shkruan se përderisa “*burrat e Dibrës po luftojshin egërsishëm mbi majat e Kërçishtit, të Korrabit dhe të Jabllanicës, familjet e Dibranëve-të qytetit e të katundeve, - ishin vu n’ikje drejt Tiranës e Elbasanit...*”.³¹ Sipas tij, numri i të shpërngulurve nga mbarë qarku i Dibrës dhe i viseve të tjera shqiptare shkonte mbi “100 000 frymë, gra, burra e çiliminj”, të cilët ishin nisur drejt “Perëndimit për mos me ranë në durë t’anmikut”.³² Gazeta “Përlindja e Shqipëniës”, më 15 tetor 1913, botoi *Thirrjen e parisë së Dibrës*, drejtuar Fuqive të Mëdha, përmbajtja e së cilës ishte si më poshtë:

“Na Dibranët, të vënë nën zgjedhën e Sërbëve që për dhjetë muaj, duruam me bindësi ç’do mënyrë shtypje, por ndjekat e fundit na forcuan në kaq dëshpërim sa ta pëlqejmë vdekjen nga robëria. Mijëra të pafajshim të ikur në male dhe shkëmbinj, janë në rezik vdekje prej të ftohti dhe urie. Gjendja e jonë e tanishme është e padurume dhe e paskëtajmëja jonë e errët dhe e panjohur. Vetëm drejtësia e Fuqive të Mëdha dhe mëshira e popujve të qytetëruëm

²⁹ Dimitrije Tucoviq, *Serbia e Shqipëria*, Tiranë 2017, 169.

³⁰ Po aty.

³¹ Haki Stërmilli, *Dibra në prag të historisë* (dorëshkrim), Tiranë 1940, 171.

³² Po aty.

*mundin të n'a shpëtojnë. Të sigurt që lutjat t'ona do dëgjohen për së shpejti, kërkojmë drejtësinë e kabineteve të Fuqive të Mëdha dhe ndërgjegjen e popullit t'Evropës, i cili është i vetëm që mund të n'a apë të drejtën të rnojmë të lirë n'atdhen t'onë të njëshëm”.*³³

Dokumentet e kohës që ruhen në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë, hedhin dritë mbi mizoritë, barbarizmat dhe masakrat e kryera nga ana e ushtrisë pushtuese serbe ndaj popullsisë civile shqiptare të fshatrave të: Prizrenit, Gostivarit, Tetovës, Kërçovës, Gjilanit, Pejës, Deçanit, Gjilanit, Ferizajt, Prishtinës etj. Kryetari i komunës së Lubizhdës, më 10 janar 1944, i raportonte Ministrisë së Punëve të Brendshme për një masakër që ushtria serbe e kishte kryer në vitin 1913 në fshatin Kabash, ku ishin masakruar 72 burra të këtij fshati. Të gjithë ata janë marrë nga ushtria serbe dhe janë pre me sëpatë te kisha e fshatit. Po atë ditë, komandanti i vullnetarëve serbë, Spiro Delloci, nga fshati Delloc i komunës së Mushtishtit, dogji për së gjalli bashkëshorten e Ali Hajdarit si dhe Haken e Muharrem Rexhepit, që të dyja nga fshati Kabash. Në të njëjtën kohë, kriminelin Spiro Delloci, masakroi 8 shqiptarë nga fshati Korishë, ndërsa nga ana e ushtrisë serbe, u morën Pren dhe Zef Çeta dhe u masakruan, i pari te kisha e Kabashit, ndërsa i dyti në afërsi të Prizrenit.

Masakra të tilla ushtria serbe kreu edhe në fshatrat e Gostivarit, si në: Simnicë, Gjenovicë, Reçan, Vërtok, Raven, Zdunje, Mirditë, Vrapçisht, Kalisht, Çegran, Qafë, Llakavicë dhe Duf. Në të gjitha këto vendbanime, siç theksohet në një dokument shqiptar, ushtria pushtuese serbe, në bashkëveprim me komitet dhe çetnikët vendorë serbë e bullgarë, në pjesën e dytë të muajit tetor 1913, vrau, theri me thikë apo me sëpatë disa qindra shqiptarë civilë, në mesin e tyre edhe gra, pleq e fëmijë. “...*Ka qenë muaji i Tetorit të vitit 1913, thuhet në dokument, kur prej katundeve Simnicë, Zdunjë, Raven, Vërtok Reçan etj., sillnin burrat shqiptarë dhe i thernin pa pikë mëshire duke i hedhun në një gropë qi ndodhet në t'hymen e katundit, duke ardhur prej Gostivari. Të gjithë burrat janë ther me thikë dhe me spata duke i pasun duart e lidhura...*”. Ndër vendbanimet që pësuan më së keqi duhet veçuar Simnicën, ku siç theksohet në dokument, ushtria serbe, pasi dogji tërë fshatin, mori 48 burra e dy gra dhe i dërgoi “... në vëndin e quajton Vakuf të Banicës dhe këtu i therrën të gjithë me thikë bashkë me Shqiptarët e tjerë t'ardhun prej katundeve

³³ “Përlindja e Shqipëniës”, 2/15 Vjesht’ e II, 1913.

*të ndryshme dhe i hodhën në një gropë e cila gjendet edhe sot në vendin e lart-përmendun...”*³⁴

³⁴*Po aty*, Lista e shqiptarëve të vrarë nga ushtria serbe në rrethin e Gostivarit gjatë muajve tetor-nëtetor 1913: Fshati Simnicë: Esat Ali Hasa (kryeplak i katundit të cilin pasi ia shkrepin një plumb e hedhin në zjarr), Ramadan Hysejn Hasa, Osman Zejnel Hasa, Vesel Ali Hasa, Hysejn Rexhep Hasa, Avzi Alim Hasa, Alim Avdi Hasa, Bexhet Dulë Shehri, Kadri Miftar Shehri, Idriz Kurteshi (i vram me dru), Hamid Rahman Gjika, Fetah Miftar Gjika, Kasam Ader Shera, Zaim Veli Hidra, Bilall Hasa, Hajdar Azizi, Ymer Musliu, bashkëshortja e Bexhet Ramë Ketës dhe bashkëshortja e Mul Bajraktarit, Xhemail Ismailin së bashku me të birin Nebiun, Rahmi Isufin, Ajvaz Ali Osmanaj, Mahmut Bajram Osmanaj, Zeno Zeqir Osmanaj, Ibish Zeqir Osmanaj, Tahir Zeqir Osmanaj, Zulfi Sadi Osmanaj, Zulvi Kurtish Keta, Izair Ram Keta, Fetah Ram Keta, Azir Ram Keta, Rustem Zeqir Keta, Sul Keta, Mehmet Durmish Keta, Behlul Jashar Keta, Iljaz Xhelil Shehri, Sinan Mehmet Gjika, Selman Nurçe Gjika, Mehmet Eles Gjika, Bexhet Emër Gjika, Sul Shaban Shahnolla, Ali Rexhep Hasa, Miftar Sait Hasa, Ymer Bexhet Shehri, Nuredin Isuf Osmanaj, Sinan Sali Keta, Ahmet Sali Keta, Abas Abdi Hasa, Riza Baftiar Gjika, Shehap Hajdin Gjika, Qamil Hysejn Gjika, Rushan Qahil Gjika dhe Dulë Musa Gjika. Fshati Gjenovicë: Halil Musliu vetë i shtati, Qahil Mersini vetë i katërti, 5 anëtarët e familjes së Xhelil Mersinit, Beqir Rustemi, Rushan Rustemi, Rustem Beluli, Tahir Yzeiri, Fejzo Aliu, Maksut Deari, Osman Saiti, Ali Jonuzi dhe Abedin Hida. Fshati Reçan: Zenun Mustafa, Alim Beshiri, Imam Ymer Hoxha, Bejtulla Dermishi, Sahit Emrullai, Sahit Beadini, Murat Bylykbashi, Rustem Yzeiri dhe i biri i tij Riza, Ebib Mustafa, Mehmet Ramadani, Sherif Selimi, Qamil Selmani, Hysejn Hajdari, Jakup Dermishi, Mehmet Abdia, Sinan Sadullai, Maliq Salia, Berzat Emrullai, Azbi Qazimi, Dehar Shasivari, Hamzë Haxhi Azizi, Jahir Tefiku, Haxhi Kasam Nuhia, Xhevdet Muharremi, Maliq Xhemaili, Hajdar Abdullai dhe i biri i tij Abdullau, Memish Selmani, Belul Zymberi, Munir Dërmishi, Halim Mustafa, Zejnel Bejtullai, Ismail Hysejini, Emin Faslia, Tahir Idrizi, Idriz Tafili, Latif Isufi, Zeliqe Rahmani, Faslije nëna e Harunit, nëna e Bexhet Hajdarit dhe nëna e Xhevahir Shasivarit. Fshati Vërtok: Selim Ademi, Xhabir Selimi (i biri), Durmish Bajrami, Afzi Dalipi, Musli Pajaziti, Iljaz Vehapi, Mejdi Vehapi, Rustem Vehapi, Gani Selmani, Fejzullah Ganiu, Rakip Mustafa, Myslim Rakipi (i biri), Xhafer Veliu, Rahim Kasami, Fehim Kasami, Aziz Myslimi, Rabie Myslimi, Xheladie Myslimi, Sevdie Mehdiu. Fshati Raven: Hamit Matjani, Ruida Matjani, Kurt Doda, vëllezërit Azir Doda, Beqir Doda, Dërvish Doda dhe nëna e tyre, trupat e të cilëve u hodhën në pus, Hasan Reçi, Abdullah Mehdiu së bashku me dy tezet e tij, Muharrem Matjani, Sul Matjani. Fshati Zdunjë: Alie Maksuti, Shuaip Maksuti së bashku me të bijën dhe gjyshen, bashkëshortja e Kurtish Shabanit, Zeqir Bilalli me bashkëshorten, bashkëshortja e Emrush Osmanit së bashku me hallën dhe babain, Abdyrrahim Jonuzi me bashkëshorten, bashkëshortja e Bexhet Zyberit, Rexhep Kurtishi me vajzën, bashkëshortja e Veli Aliut, vajza e Gjyljas Iljazit, Vehap Afziu, Jonuz Xhaferi, Kurdali Mustafa me djalin dhe babain, Beqir Demiri, Zeqir Shemsija, Myrtezan Mehmeti, Qerim Kadria, Sulejman Lutfija, i biri i Hamit Zemzunit; Aqif Yzeiri, Zulfiqar Zyberi, Myrtezan Ramadani me bashkëshorten dhe vajzën, Shaqir

Krimet dhe mizoritë serbe në tokat e pushtuara shqiptare vazhduan edhe gjatë viteve 1914-1915. Në prill të vitit 1914, ushtria serbe dogji tërë katundin Ponoshec të rrethit të Gjakovës, dhe vrau 70 shqiptarë të atij fshati, për shkak se në afërsi të fshatit ishte gjetur i

Kasami, Mustafa Beqiri, Alit Osmani, Milaim Sinani, Ibrahim Alia me nënën, Mulla Feta Jahja, Mixhait Jahja, Xhabir Aliu, Hysenj Rushiti, Kasëm Mehmeti, Naqil Shemsija, Shemsi Ymeri, Hajdar Alija, Dervish Shemsija; Fshati Mirditë: Hysenj Nuredini, Qahil Sadiku, Pajazit Ahmeti, Hamid Ahmeti, Bajram Ahmeti, Riza Pajaziti, Mehmet Limani, Lazëm Limani, Iljas Limani dhe Zylfiqar Lazami; Fshati Debresh: Hamzë Haxhi Mustafa, Hasan Zylbehari, Tefik Ahmeti, Adurrahim Qazimi, Rashid Sulejmani, Berzat Shabani dhe Mustafa Shahini, Nezir Sulejmani dhe Rustem Mustafa. Katundi Vrapçisht: Hamzë Ahmeti, Haxhi Ahmeti, Jonus Mehmeti, Hamit Elmazi, Jusuf Halili, Yzeir Xhemaili, Ejup Emini, Ali Jahja, Ahmet Vranka, Havzi Agushi, Ali Zylbehari, Ramadan Halimi, Ejup Emini, Gafur Jakupi; Fshati Dobridoll: Asllan Baftija, Abdi Jusufi, Aqif Bakija, Qamil Pajaziti dhe Rakip Pajaziti. Fshati Kalishtë: Mehmet Rustemi, Baki Lutfiu, Mehmet Bilali, Lazëm Mahmuti, Sherif Muslija, Shuaip Xhemali, Islam Limani, Etem Rushiti, Rushit Etemi, Demir Jusufi, Bexhet Mustafa, Mustafë Islami, Mehmet Tahiri, Kadri Hysenji, Rexhep Xhemaili, Osman Zejneli, Jakup Rahmani, Kamber Jonuzi, Adem Latifi, Mehdi Bekteshi, Jusuf Maliki, Xhabir Ajrullai, Shaban Fehrati, Emin Hasani, Zyraf Hasani, Xhemail Shemsia, Xhafer Shaqiri, Nebi Rexhepi, Nezir Mustafa, Kamber Ramadani, Seadin Abdullahi, Ysman Ahmeti, Zaim Sinani, Rakip Sinani, Shuaip Mustafa, Murtezan Rexhepi, Rahim Ahmeti, Berzat Bajrami, Ibish Alija, Halim Rustemi, Mesin Myftari, Beqir Myftari dhe Atixhe Mema. Fshati Çegran: Bilal Fasliu, Jusuf Murati, Akik Hasani, Çerkes Ferhati, Mehmet Aliti, Bajram Iljasi, Çela Durmishi, Elmas Fetahu, Aziz Bakiu, Jusuf Shasivari, Milahim Shaqiri, Fejzullah Neziri, Ajet Sulejmani, Bajram Xheladini, Osman Hajdari, Selman Limani, Yzair Selimi, Rifat Selimi, Azir Ramadani, Ysenj Saliu, Kasëm Aliti, Rakip Limani, Sadik Muharremi, Rahman Zendeli, Idriz Latifi, Beqir Ysmani, Shuaip Zeqiri dhe Hasan Azizi. Fshati Qafë: Murat Sedini me bashkëshorten, tre djemë dhe një vajzë; Jonus Sedini me bashkëshorten, 1 djalë dhe 2 vajza; Zenel Alili me bashkëshorten; Mehmet Alili me bashkëshorten, 3 djem dhe 1 vajzë; Halim Rahmani me bashkëshorten, 3 djem dhe 1 vajzë; Riza Rahmani me bashkëshorten dhe dy djem; Hajdin Sedini me bashkëshorten, 2 djem dhe 1 vajzë; Selman Bilalli me bashkëshorten dhe dy vajza; Murat Bilalli me bashkëshorten dhe 2 vajza; Liman Ramadani me bashkëshorten dhe një vajzë; Kamber Sedini me bashkëshorten; Idriz Sedini me bashkëshorten, një djal dhe dy vajza; Mazllam Saliu me bashkëshorten, dy djem dhe dy vajza, si dhe Sulltana, gjithashtu vajza e Mazllamit, e cila tregoi një heroizëm të paparë ndonjëherë, sepse në momentin kur çetnikët serbë e morrën babain e saj për ta pushkatuar, ajo rroki gërshërët dhe doli në oborr të shtëpisë dhe e goditi nipin e kryetarit të çetnikëve, Stojanin, si dhe dy të tjerë, që më pas edhe ajo të vritet nga një çetnik tjetër. Fshati Llakavicë: Islam Dervishi, Tefik Islami, Xhafer Zenko dhe Islam Fetai. Fshati Duf: Nezir Selimi dhe Jonus Xhaferi.

vdekur një ushtar serb dhe dy tjerë të plagosur.³⁵ Kjo masakër është kryer me urdhër të gjeneralit të ushtrisë serbe, Mira Veshoviq, në të cilën kanë marrë pjesë dy batalione të këmbëtorisë dhe artileria e vendosur rreth e përqark fshatit.³⁶ Po gjatë këtij viti, ushtria serbe kreu edhe një masakër tjetër në fshatin Banjë të Suharekës, duke vra gjithsej 21 meshkuj të këtij fshati.³⁷ Kryetari i Komunës së Sanakosit, Mehmet Bushi, më 21 gusht 1944, Ministrisë së Punëve të Brendshme në Tiranë, ia dërgoi listën prej 153 personave të vrarë gjatë vitit 1915 nga ushtria serbe, të fshatrave të asaj komune si: Gradec, Pirok, Negotinë, Gjergjevishtë, Sanekos, Llomnicë dhe Gorjan.³⁸ Ndërkohë,

³⁵ AQSH.F.410.V.1944. D. 112. Fl. 2-4, Lista e të vrarëve nga fshati Ponoshec prej ushtrisë serbe në prill të vitit 1914: Sadik Rama, Halil Sadiki, Zenun Sadiki, Sadri Muslija, Zejnel Sadiku, Ukë Arifi, Ramë Sadiki, Mon Arifi, Sylë Bajrami, Bajram Sylja, Zenun Bajrami, Avdyl Alija, Myftar Alija, Ramë Veseli, Rexhep Hetemi, Sali Rama, Rexhep Latifi, Bajram Neziri, Ali Sylja, Zekë Sylja, Ukë Rexhepi, Adem Sejdia, Avdyl Duçi, Ahmet Ademi, Osman Rexha, Imer Rexha, Ahmet Ismaili, Zojë Ismaili, Ramë Avdyli, Ibish Hamza, Ukë Avdyli, Ali Avdyli, Sadik Hoxha, Myrt Ahmeti, Sahit Alija, Adem Bajrami, Sadri Bajrami, Rexhep Rustemi, Osman Ademi, Zenun Ademi, Hysejné Ademi, Sali Ademi, Sylë Salih, Osman Ademi, Shaban Rexhepi, Idriz Rexhepi, Sadri Zenuni, Rustem Zenuni, Abaz Sulejmani, Man Abazi, Avdyl Abazi, Isuf Zyberi, Hazir Zyberi, Hasan Ahmeti, Gjylë Zeqirjau, Myftar Hasani, Arif Ahmeti, Bajzit Ahmeti, Isuf Ahmeti, Bajram Isufi, Shaban Isufi, Zenun Sadiku, Ramë Sadrija, Sadik Zenuni, Mal Hasani, Sejdi Ademi, Adem Sejdi, Myftar Shinari, Musë Shinari, Rexhep Selimi.

³⁶ Po aty.

³⁷ AQSH.F.410.V.1944.D.58.Fl.16, Lista e të vrarëve nga fshati Banjë prej ushtrisë serbe në vitin 1914: Ali Tahiri, Rahmon Hajdini, Islam Rexhepi, Liman Hajdini, Mehmet Maliqi, Bajram Beqiri, Bajram Sulejmani, Ahmet Rahmoni, Emin Ibrahim, Qerim Zeneli, Halim Mustafa, Hysejn Murseli, Elez Hasani, Shaqir Limani, Sefer Limani, Denush Limani, Bahti Shali Ferizi, Pajazit Rexhepi, Hasan Haliti, Osman Zeqiri.

³⁸ *Lista që përmban emërat e të vrarëve prej Serbvet të rajonit Komunës Senakosit.*- 1. Ramadan Dauti, Gradec; 2. Ejup Hasani, Gradec; 3. Zenun Durmishi, Gradec; 4. Ismail Izairi, Gradec; 5. Abdurahim Ahmeti, Gradec; 6. Hisë Abdullahi, Gradec; 7. Jonuz Tahiri, Gradec; 8. Beqir Tahiri, Gradec; 9. Nuredin Iljazi, Gradec; 10. Sali Iljazi, Gradec; 11. Bilall Salija, Gradec; 12. Sahit Elmazi, Gradec; 13. Esat Alija, Gradec; 14. Jahja Shabani, Gradec; 15. Feta Rexhepi, Gradec; 16. Musli Shabani, Gradec; 17. Jamin Musa, Gradec; 18. Shuaip Jahja, Gradec; 19. Ramadan Ejupi, Gradec; 20. Hasip Iljazi, Gradec; 21. Ibrahim Ahmeti, Gradec; 22. Havzi Ademi, Gradec; 23. Zylbehar Ademi, Gradec; 24. Zeqir Ademi, Gradec; 25. Ramadan Tahiri, Gradec; 26. Hajdar Ramadani, Gradec; 27. Tahir Ramadani, Gradec; 28. Shuaip Tahiri, Gradec; 29. Ibrahim Tahiri, Gradec; 30. Iljaz Tahiri, Gradec; 31. Hashim Iljazi, Gradec; 32. Jusuf Iljazi, Gradec; 33. Rexhep Bajrami,

në raportin e kryetarit të Komunës së Zhelinës, Abdurahman Reka, thuhet se në fshatin Debërcë të Dervenit të Epërm, në nëntor të vitit

Gradec; 34. Sali Hyseini, Gradec; 35. Zeqir Nimani, Gradec; 36. Mahmut Sulejmani, Gradec; 37. Mehmet Selmani, Gradec; 38. Ahmet Ismaili, Gradec; 39. Rufat Ahmeti, Gradec; 40. Hasan Ahmeti, Gradec; 41. Berzat Abazi, Gradec; 42. Abaz Bajrami, Gradec; 43. Ibrahim Nuredini, Gradec; 44. Rushit Abdija, Gradec; 45. Abdulla Abdija, Gradec; 46. Iljaz Abdija, Gradec; 47. Izet Abdija, Gradec; 48. Adem Nuredini, Gradec; 49. Asllan Xhemaili, Gradec; 50. Mustafa Iseni, Gradec; 51. Zejnel Shaqiri, Gradec; 52. Hazir Zejneli, Gradec; 53. Hamit Bajrami, Gradec; 54. Isman Bajrami, Gradec; 55. Ismail Abazi, Gradec; 56. Zylfi Ibrahimimi, Gradec; 57. Hakik Ibrahimimi, Gradec; 58. Rufat Ramadani, Gradec; 59. Sali Bilali, Gradec; 60. Selim Salija, Gradec; 61. Sali Osmani, Gradec; 62. Dalip Jahja, Gradec; 63. Xhabir Jahja, Gradec; 64. Ali Hasani, Gradec; 65. Izet Rushani, Gradec; 66. Rakip Jusufi, Gradec; 67. Ibrahim Hajredini, Gradec; 68. Vesel Ahmeti, Gradec; 69. Kurtish Alija, Gradec; 70. Rexhep Dauti, Gradec; 71. Shaban Rexhepi, Gradec; 72. Osman Rexhepi, Gradec; 73. Ramadan Beqiri, Gradec; 74. Imer Beqiri, Gradec; 75. Xhemail Hasani, Gradec; 76. Imer Idrizi, Gradec; 77. Selim Ahmeti, Gradec; 78. Izair Ahmeti, Gradec; 79. Xhemil Halili, Gradec; 80. Fetah Hamiti, Gradec; 81. Idriz Qazimi, Gradec; 82. Sherif Ibrahimimi, Gradec; 83. Rufat Osmani, Gradec; 84. Zylfi Rexhepi, Gradec; 85. Aziz Hasani, Gradec; 86. Mustafa Imeri, Gradec; 87. Halim Beqiri, Gradec; 88. Xheladin Lutfiu, Gradec; 89. Zeqirja Xheladini, Gradec; 90. Riza Selimi, Gradec; 91. Halit Sahiti, Gradec; 92. Tahir Ahmeti, Gradec; 93. Ramadan Sahiti, Gradec; 94. Idriz Rushiti, Gradec; 95. Qazim Sahiti, Gradec; 96. Beqir Beluli, Gradec; 97. Ali Beqiri, Gradec; 98. Sali Sulejmani, Gradec; 99. Mehmet Shabani, Gradec; 100. Ajet Shabani, Gradec; 101. Veli Adili, Gradec; 102. Bajram Velija, Gradec; 103. Kamber Jakupi, Gradec; 104. Shuaip Kamberi, Gradec; 105. Sulejman Mahmuti, Gradec; 106. Qamil Mahmuti, Gradec; 107. Ibrahim Salija, Gradec; 108. Sulejman Dauti, Pirok; 109. Sabri Hajdari, Pirok; 110. Ibrahim Sulejmani, Pirok; 111. Tahir Murati, Pirok; 112. Daut Nuredini, Pirok; 113. Asllan Ademi, Negotinë; 114. Ebip Osmani, Negotinë; 115. Rahim Ebibi, Negotinë; 116. Abdullah Ramadani, Negotinë; 117. Arif Imeri, Gjurgjovishtë; 118. Imer Zeneli, Gjurgjovishtë; 119. Xhemali Zeqiri, Senokos; 120. Kadri Emrullahi, Senokos; 121. Ali Osmani, Senokos; 122. Sali Dauti, Senokos; 123. Hazir Bilali, Senokos; 124. Ibrahim Ferati, Senokos; 125. Naim Ferati, Senokos; 126. Izair Ibrahimimi, Senokos; 127. Idriz Mustafa, Senokos; 128. Xhelil Tafili, Senokos; 129. Ali Osmani, Senokos; 130. Jonuz Zeqiri, Senokos; 131. Sherka Kadrija, Senokos; 132. Isnishahe Zeqiri, Senokos; 133. Zejnep Ibrahimimi, Senokos; 134. Nazime Jahja, Senokos; 135. Rakip Skënderi, Llomnicë; 136. Mehmet Skënderi, Llomnicë; 137. Sulejman Xhaferi, Llomnicë; 138. Shaqir Bexheti, Llomnicë; 139. Bajram Etemi, Llomnicë; 140. Zylfi Bexheti, Llomnicë; 141. Bejtulla Jusufi, Llomnicë; 142. Bajram Ramadani, Llomnicë; 143. Izair Sulejmani, Llomnicë; 144. Ismail Haxhija, Llomnicë; 145. Muharem Salija, Llomnicë; 146. Mehmet Zeqiri, Llomnicë; 147. Bajram Nuhija, Gorjan; 148. Qamil Bajrami, Gorjan; 149. Asllan Durmishi, Gorjan; 150. Zyber Sinani, Gorjan; 151. Hamit Hasani, Gorjan; 152. Zeqir Hamzaji, Gorjan; 153. Behadin Mustafa, Gorjan.

1915: “87 burra të gjithë në moshë madhore, janë kap prej ushtris dhe Gjindarmëris Serbo-malazeze, e masi janë lidhë i kanë çue në vendin e quejtun “Klisura” (rruga e përgjithshme Shkup-Tetovë) dhe i kanë vra... Kjo vrasje, vazhdon raporti, omadike asht bamun pa as ma të voglën arsye, por vetëm e vetëm për me torturue e kallë tmerin popullit Shqiptar, që të detyroheshin me lanë fushat pjellore, në duar të kolonizatorëvet Serb e Malazez...”.³⁹

Në përmbyllje të këtij punimi studimor, është e rëndësishme të vihet në pah fakti se të gjitha krimet dhe mizoritë serbe në Kosovë dhe në Trevat Lindore Shqiptare gjatë viteve 1912-1915, kryheshin për t’i detyruar shqiptarët që të shpërnguleshin për në Turqi ose brenda kufijve të shtetit shqiptar, ndërsa në shtëpitë dhe pronat e tyre të vendoseshin kolonistët serbë e malazezë. Një plan i tillë, fatmirësisht nuk u realizua në ato përmasa siç e kishin parashikuar qarqet e atëhershme hegjemoniste serbe, falë vendosmërisë së popullit shqiptar, i cili, siç thuhet në një dokument shqiptar “pranoj ç’do torturë e barbarizëm që përdorshin sllavët dhe tokën e tyne nuk e lanë por e ruejtën deri në sotë”.⁴⁰

³⁹ AQSH.F.410.V.1944.D. 110.Fl.1, Raport i kryetarit të Komunës së Zhelinës, Abdurahman Reka, dërguar prefekturës së Tetovës, mbi krimet dhe barbarizmat serbe në vendbanimet e asaj komune gjatë viteve 1912-1915.

⁴⁰ Po aty, Fl. 2-3, Raport i kryetarit të Komunës së Stençes të nënprefekturës së Rekës, Rauf Tërshana, dërguar prefekturës së Dibrës, mbi krimet dhe barbarizmat serbe në vendbanimet e asaj komune në harkun kohor 1912-1941.